



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 11 gusht 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Ndryshimin e Numrit të
Lejuar të Fjalëve**

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenin 39(13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe nenet 36(1) dhe (2) dhe (41) të Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara (“Udhëzuesi i Punës”),² nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 12 korrik 2022, mbrojtësit e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit (bashkërisht “Mbrojtja”) dorëzuan një kërkesë të përbashkët për nxjerrje informacioni (“Kërkesa e Përbashkët e Mbrojtjes sipas Rregullës 103”) në bazë të rregullës 103 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”).³

2. Më 3 gusht 2022, pasi kishte shfrytëzuar shtyrjen e afatit,⁴ Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi përgjigjen ndaj Kërkesës së Përbashkët të Mbrojtjes sipas Rregullës 103 (“Përgjigja e ZPS-së”).⁵

3. Më 10 gusht 2022, Mbrojtja i kërkoi Gjykatësit të Procedurës Paraprake të miratonte një maksimum prej e 2500 fjalësh për kundërpërgjigjen e përbashkët të Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së ZPS-së (“Kërkesa”).⁶ Mbrojtja parashtron se duhet të

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BD-15, Udhëzuesi i Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara, 17 maj 2019, publik.

³ KSC-BC-2020-06, F00877, Mbrojtja, *Mocion i Përbashkët i Mbrojtjes për Nxjerrje Informacioni sipas Rregullës 103*, 12 korrik 2022, konfidencial, me Shtojcat 1-3, publike, dhe Shtojcën 4, konfidenciale. Një version i korigjuar konfidencial u dorëzua më 21 korrik 2022, F00877/COR, me Shtojcën 1, konfidenciale. Një version i redaktuar publik u dorëzua më 13 korrik 2022, F00877/RED.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00889, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Shtyrjen e Afatit për Përgjigjen ndaj Mocionit të Përbashkët të Mbrojtjes për Nxjerrje Informacioni sipas Rregullës 103 (F00877)*, 19 korrik 2022, publik.

⁵ KSC-BC-2020-06, F00910, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocionit të Përbashkët të Mbrojtjes për Nxjerrje Informacioni sipas Rregullës 103’ (F00877)*, 3 gusht 2022, konfidenciale.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00922, Mbrojtja, *Kërkesë e Mbrojtjes për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Dorëzimin e Kundërpërgjigjes së Përbashkët ndaj Parashtrimit të Protokolluar F00910 të ZPS-së*, 10 gusht 2022, publike.

merren parasysh të njëjtat arsyetime që e shtynë Gjykatësin e Procedurës Paraprake të miratonte shtimin e numrit të fjalëve në një rast të mëparshëm edhe në këtë rast.⁷ Gjithashtu, Mbrojtja parashtron se Kërkesa është në kohë.⁸ Së fundmi, ajo parashtron se miratimi i Kërkesës nuk dëmton ZPS-në; përkundrazi, ZPS-ja do të përfitojë nga marrja e një kundërpërgjigjeje të vetme në vend të katër kundërpërgjigjeve të veçanta.⁹

II. DISPOZITATA LIGJORE PËRKATËSE

4. Në bazë të nenit 41 të Udhëzuesit të Punës, kundërpërgjigjet ndaj përgjigjeve nuk duhet të jenë më shumë se 2.000 fjalë.

5. Në përputhje me nenin 36(1) të Udhëzuesit të Punës, një pjesëmarrës në proces mund të bëjë kërkesë, paraprakisht në kohë të mjaftueshme, për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve, nëse tregon se ka arsye të vlefshme për rrethana të posaçme.

6. Në përputhje me nenin 36(2) të Udhëzuesit të Punës, në qoftë se nuk i shkaktohet dëm palës kundërshtare ose mbrojtësit të viktimave, mocioni për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve mund të miratohet pa u dhënë atyre mundësinë për t'u shprehur.

III. DISKUTIM

7. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Kërkesa është bërë në kohë të mjaftueshme para afatit të dorëzimit të kundërpërgjigjeve nga ana e Mbrojtjes, siç përcaktohet në nenin 36(1) të Udhëzuesit të Punës.

⁷ Kërkesa, para. 3, që i referohet KSC-BC-2020-06, F00834, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve*, 10 qershor 2022, publik.

⁸ Kërkesa, para. 4, dhe poshtëshënimi 3.

⁹ Kërkesa, para. 4, dhe poshtëshënimi 4.

8. Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh argumentet e Mbrojtjes lidhur me (i) rëndësinë e angazhimit për nxjerrje informacioni sipas rregullës 103 të Rregullores dhe posaçërisht të temës në fjalë; dhe (ii) argumentet e shumta që janë parashtruar me anë të Kërkesës së Përbashkët të Mbrojtjes sipas Rregullës 103. Për më tepër, duke marrë parasysh se numri i fjalëve që kërkohet të shtohen nuk është i lartë dhe mundëson dorëzimin e një kundërpërgjigjeje të vetme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se miratimi i kërkesës nuk dëmton ZPS-në.

9. Për rrjedhojë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se është treguar se ekzistojnë arsye të vlefshme për miratimin e shtimit të kërkuar të numrit të fjalëve. Për pasojë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lejon shtimin deri me 500 fjalë të numrit të lejuar të fjalëve për kundërpërgjigjen e përbashkët të Mbrojtjes.

IV. VENDIM

10. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

MIRATON Kërkesën.

//nënshkrimi//

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E enjte, 11 gusht 2022
Hagë, Holandë.